

Më
 Dana 04 - 11 - 2016

P.nr.637/15



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtarja, Hysnije Gashi, procesmbajtëse Ibadete Haliti , në çështjen penale kundër të pandehurit, [REDACTED] nga Ferizaj rr, “[REDACTED]” K. Ferizaj, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH – në Ferizaj, PP/ nr 2160-6/14 . të dt. 18.05.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 19.09.2016. në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit te shtetit Ismet Rrahmani, të akuzuarit, te njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri, [REDACTED] , nga Ferizaj rr “[REDACTED]” Komuna Ferizaj, i lindur me [REDACTED] në fshatin [REDACTED] K. Kaçanik nga i ati [REDACTED] , dhe e ëma [REDACTED] i vajzërisë [REDACTED] me profesion kuzhinier i papunë, ka kryer shkollën e mesme, gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE

Me dt. 26.08.2014, rreth orës 13:15, në banesën e tyre në rrugën “[REDACTED]” në Ferizaj, pas një mosmarrëveshje verbale me të dëmtuarën-bashkëshorten e tij [REDACTED] për shkak të vizitës së saj, te motra e saj, e kishte sulmuar fizikisht me grusht në krahun e djathtë, me ç'rast e dëmtuara kishte marrë lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje dhe gërvishje në kraharor, ndrydhje në nyjën e kryqit të dorës së djathtë dhe krahut të majtë, me pasoja të përkohshme për shëndetin,

Me të cilën kreu veprë penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 par.2 dhe nën par 1.4 të KPRK-së

Andaj në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe nen. 4,7,21,41,49,50,51,52,73, të KPK si dhe nen. 365 të KPPK-së,

G J Y K O N
D Ē N I M M E K U S H T

Dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili denim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin prej 1/një/ viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

E dëmtuara –bashkëshortja [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil

I pandehuri është i obliguar që të paguaj shpenzimet e paushallin gjyqësor në lartësi prej 30 € komfor nenit 450 par.2 nën par.2.6 dhe par.3 dhe neni 451 të KPPK-së .

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën, PP/II.nr.2160-6/14, te datës 18.05.2015, e ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR], për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par .1 pika .1.4 të KPRK –së.

Gjykata duke vepruar në këtë qështje penale mbajti shqyrtimin fillestar me dt. 19.09.2016, në të cilën përfaqësuesi i akuzës - prokurori i shtetit Ismet Rrahmani, mbeti në tërësi pranë akuzës së ngritur duke i propozuar gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit, si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri ,

-pranimi i fajit mbështetët në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, raporti mjekësorë nga Qendra Emergjente në Ferizaj i dt.26.08.2014, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjeksisë i dt. 06.03.2015, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lëndës dhe nuk ka asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabim faktik.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari, konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par 1.4 të KPRK-së

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se që në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, nuk është vërtetuar se ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, i gjendjes së dobët ekonomike, në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjeneralë, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

E dëmtuara –bashkëshortja [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil

I pandehuri është i obliguar që të paguaj shpenzimet e paushallin gjyqësor në lartësi prej 30 € komfor nenit 450 par.2 nën par.2.6 dhe par.3 dhe neni 451 të KPPRK-së.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P. nr. 637/15 dt. 04.10.2016

Procesmbajtëse

Ibadete Haliti

Gjyqtare:

Hysnije Gashi



KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpër mes të kësaj gjykate.